



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

---

**C.nr. 214/2013**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit B. H., nga Prizreni, Rr. ..., nr..., të cilin me autorizim e përfaqëson D. R., avokat nga Prizreni, kundër të paditurve Sh.p.k. "U." Trafiku Urbano-Periferik në Prizren, Rr. , p.n., G. S. nga Prishtina Rr., nr. .. dhe J. S., nga Prishtina, Rr. , p.n., të cilët me autorizim i përfaqëson Juristi Betim Kadolli, nga Prizreni, për kompensimin e të ardhurave personale, pas seancës së shqyrtimit kryesor publik, me datë, 20 Prill 2016, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Miratohet kërkesëpadia e paditësit B. H., nga Prizreni.

Detyrohen të paditurit: Sh.p.k. "U." Trafiku Urbano-Periferik në Prizren, G. S. nga Prishtina dhe J. S., nga Prishtina, në mënyrë solidarë t'i paguajnë paditësit B. H. nga Prizreni, kompensimin e të ardhurave personale për muajin Prill shumë 500,00 €, për muajin Gusht 500,00 € si dhe për 20 ditë pune për muajin Shtator 2012 shumë 325,00 €, gjithsejtë shumë e përgjithshme 1.385,00 € dhe pagesën për trustin pensional për muajin Shtator, të gjitha këto me kamat , sipas normës që paguajnë bankat afariste në Kosovë për depozitat e pa afatizuara të kursimit, pa destinim të caktuar, mbi një vit, duke filluar nga data 11.03.2013 deri te pagesa definitive. Si dhe në emër të kompensimit për shpenzimet e procedurës shumë e përgjithshme 430,00 €, të gjitha këto në afat brenda 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nënë kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi në padi dhe gjatë seancave, përmes të autorizuarit të vetë paraqet se që nga viti 2009 ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura Ndërmarrja sh.p.k "U.", si punëtor i rregullt, i caktuar në punë dhe detyra të punës automekanik, i cili ka qenë mirëmbajtës i vetëm i të gjithë autobusëve të Trafikut Urbano-Periferik në Prizren.

Paditësit në muajin Shtator të vitit 2012, në mënyrë arbitrare i është ndërprerë marrëdhënia e punës, pa kurrfarë baze dhe pa kurrfarë vendimi. Përkundër kësaj të njejtit nuk i është paguar kompensimi për punën e bërë dhe atë për muajt Prill, Gusht dhe Shtator të vitit 2012 si dhe nuk i janë paguar kontributet pensionale për muajin Shtator 2012. Kontrata e punës asnjëherë deri më tani nuk i është dhënë paditësit nga e paditura. Në seancën përgatitore të datës 11 Mars 2016, e përmirëson padinë, duke sqaruar se gabimisht është kërkuar për muajin Mars, në vend të muajit Mars, 2012 duhet të jetë muaji Prill, 2012.

Thekson se nga administrimi i provave, përkatësisht nga transaksionet bankare pranë Bankës Ekonomike si dhe nga raporti i Trustit Pensional, për paditësin në mënyrë të rregullte i janë paguar të ardhurat dhe kontributet përpos për muajt Prill, Gushtë dhe Shtator. Propozon miratimin e kërkesëpadisë. I kërkon shpenzimet e procedurës dhe atë për tri seanca nga 135,00 € për seancë, gjithsejtë 405,00 € dhe 25,00 € për taksa gjyqësore, gjithsejtë në shumën e përgjithshme 430,00 €.

Të paditurit në theksimet e tyre gjatë seancave gjyqësore përmes të autorizuarit të tyre, paraqesin se e kundërshtojnë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paraqitur. Nga provat e paraqitura nga vetë pala paditëse vërtetohet se e kanë kryer në tërësi detyrimin dhe i kanë paguar në tërësi të ardhurat personale për paditësin. Nuk e kanë kundërshtuar propozimin e palës paditëse për provat të cilat i ka propozuar për t'u administruar gjatë seancës së shqyrtimit kryesor. Propozojnë refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar. I kërkojnë shpenzimet e procedurës, por nuk i specifikojnë ato duke mos paraqitur edhe shumën e tyre.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat dhe atë: me shikim në raportin për rroga, për muajin Gushtë 2012, e regjistruar në shkresat e lëndës nën numrin rendor 4; me shikim në Raportin e Historiatit të Llogarisë Rrjedhëse nr. 420848, për klientin B. H. nga data 01.08.2011 deri më 19.10.2012; me shikim në pasqyrën e trustit pensional për kontribuuesin B. H.; me shikim në Kërkesën e punëtorit B. H. drejtuar SH.P.K. "U." në Prizren dhe Kompania "F. G." – Prishtinë datë 21.01.2013, së bashku me vërtetimin mbi pranimin e dërgesës; me shikim në Ankesën e paditësit drejtuar Inspektoratit të punës në Prizren datë 12.02.2013; me shikim mbi qira për dhënie e lokalit afarist datë 01.09.2010; me shikim në kontratën për qiranë e parkingut për autobus e protokolluar nr. 144 datë 03.08.2010; me shikim në ID – të e punëtorëve të "Urban" së bashku me listën e punëtorëve të cilët kanë bërë shkarkimin përmes ID kartelave për ditë të punës si dhe shikim në kartelën mujore për furnizim me derivate të naftës për të gjithë autobusët e "U." në Pompën N.T. "G. P.".

Nga raporti për rroga vërtetohet se ky dokument është përpiluar nga e paditura sh.p.k. "U.", për të paguar rrogat për punëtorët për muajin Gusht 2012, ndër tjerë edhe për paditësin B. H. në shuma 449,00 €.

Nga Raporti i Historiatit të Llogarisë Rrjedhëse nr. 420848, për klientin B. H. nga data 01.08.2011 deri më 19.10.2012, vërtetohet se rrogat për muajin Prill 2012, Gusht 2012 dhe për muajin Shtator 2012, nuk i janë paguar paditësit B. H.. Këtë fakt gjykata e vërteton nga fakti se nëse i referohemi në mënyrë kronologjike pagesave të rrogave, veçanërisht pagesës së bërë me datë 01.08.2011 dhe asaj 29.08.2011, nga rubrika përshkrimi vërtetohet se pagesa e datës 01.08.2011 është bërë për muajin Qershor 2011, ndërsa pagesa e datës 29.08.2011 është bërë për muajin Korrik 2011. Duke përcjell këtë kronologji të pagesave, në rubrikën përshkrimi, pagesa për muajin Shkurt 2011 është bërë me datë 15.03.2012. Ndërsa për muajin Prill 2012 nga ky historiat nuk evidentohet se është bërë ndonjë pagesë. Pagesa e radhës është bërë për muajin Maj 2012 dhe atë me datë 25.06.2012. Gjithashtu edhe pagesa për muajin Gusht 2012 nuk është e evidentuar se është bërë. Pagesa e datës 16.08.2012 është bërë për muajin 07/2012, e jo siç pretendohet nga pala e paditur.

Nga pasqyrë e trustit penional për kontribuuesin B. H., vërtetohet se nuk janë paguar kontributet pensionale për muajin Shtator 2012. Kjo është vërtetuar se kontributi nga punëtori dhe punëdhënësi ka qen secili të paguan shumën 75€, ndërsa për muaj Prill,

Gushtë dhe Shtator janë paguar vetëm nga 25 €, nga punëtori dhe punëdhënësi, që i bie se për këtë periudhë përveç kontributeve pensionale, nuk janë paguar as pagat e paditësit.

Nga Ankesa e paditësit drejtuar Inspektoratit të punës në Prizren datë 12.02.2013, vërtetohet se paditësi ka paraqitur ankesë pran Inspektoratit të Punës në Prizren, me të cilën ka kërkuar që të merr veprime për t'i paguar rroga e papaguara për majin prill, Gusht dhe Shtator të vitit 2012.

Nga kontrata mbi qira për dhënie e lokalit afarist datë 01.09.2010 dhe kontratë për qiranë e parkingut për autobus e protokolluar nr. 144 datë 03.08.2010, vërtetohet se paditësi B. H., përveç punës si mbikëqyrës dhe vozitës, ka pas autorizim që të nënshkruan kontrata në emër të paditurës me persona të tretë.

Nga ID – të e punëtorëve të “U.” së bashku me listën e punëtorëve të cilët kanë bërë shkakimin përmes ID kartelave për ditë të punës si dhe shikimi në kartelën mujore për furnizim me derivate të naftës për të gjithë autobusët e “U.” në Pompën N.T. “G. P.”, vërtetohet se ka qenë në punë dhe i njëjti ka nënshkruar këto dokumente gjatë muajit Prill, Gusht dhe Shtator të vitit 2012.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ( LPK ), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka gjetur se:

**Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.**

Për palët ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësi B. H. ka punuar tek e paditura gjatë muajve Prill, Gusht dhe Shtator të vitit 2012.

Kontestuese për palët ndërgjyqëse është fakti nëse paditësit i janë paguar rrogat për muajin Prill, Gusht dhe Shtator të vitit 2012.

Nga provat e administruara, përkatësisht Historiatit të Llogarisë Rrjedhëse nr. 420848, për klientin B. H. nga data 01.08.2011 deri më 19.10.2012, raporti për rroga i cili është përpiluar nga e paditura sh.p.k. "U.", si dhe pasqyrë e trustit penional për kontribuuesin B. H., gjykata ka gjetur se për muaj Prill, Gusht dhe Shtator 2012, e paditura nuk i ka paguar rrogat dhe kontributet paditësi.

Në kuptim të nenit 55 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 të Ligjit të Punës, i punësuari ka të drejtë në pagë, e cila është përcaktuar në kontratën e punës. Paga mund të paguhet përmes transferit bankar apo para të gatëshme, ku punëdhënësi për këtë ku punëdhënësi duhet të nxjerr një deklaratë për çdo pagesë dhe të mbajë regjistër për pagesat e bëra. Gjë që në rastin konkret për muajt prill, Gusht dhe Shtator nuk janë paguar të ardhurat personale për paditësin. Gjithashtu pala e paditur me asnjë provë të vetme nuk ka paraqitur që ka mbajtur regjistër të pagesave të bëra apo të ketë nxjerr ndonjë deklaratë për çdo pagesë, siç përcakton nenin i lartcekur.

Në rastin konkret, nga përcjellja kronologjike pagesa për muajin Shkurt 2011 është bërë me datë 15.03.2012, ndërsa për muajin Prill 2012, nga kjo provë nuk evidentohet se është bërë ndonjë pagesë. Gjithashtu pagesa e radhës është bërë për muajin Maj 2012 dhe atë me datë 25.06.2012. ndërsa pagesa për muajin Gusht 2012 nuk është e evidentuar se

është bërë. Pagesa e datës 16.08 2012 është bërë për muajin 07/2012, e jo siç pretendohet nga pala e paditur.

Po ashtu gjykata ka vërtetuar se raporti për rroga i cili është përpiluar nga e paditura, më tepër është urdhër për lëshimin e rrogave se sa një pagesë e kryer. Gjykata ka vlerësuar pretendimet e palës së paditure se me këtë dëshmohet se janë paguar rrogat për punëtorët e listuar në atë raporte, por kësaj nuk i ka kushtuar besimin nga fakti se ai raporte nuk paraqet një dokument me të cilin është bërë pagesa, ai është një dokument intern i të paditurës.

Gjykata në kuptim të nenit 452 lidhur me nenin 463të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi që të detyron palën e paditur t'i kompensojë palës paditëse shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 430,00 €, duke llogaritur për 3 seanca për përfaqësim nga 135,00 € gjithsejtë 405,00 € dhe 25,00 € për taksën për padi, shuma të cilat janë në përputhje me Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

### GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C. nr. 214/2013, datë 20 Prill 2016

Gjyqtari,  
Atdhe Berisha

**UDHËZIME PËR ANKESË:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7, pas marrjes të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.